



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANË
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

N J O F T I M

Për aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2023-2024

Ju njoftojmë se kanë filluar aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, që ofron Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për vitin akademik 2023-2024, përkatësisht në programet e ofruar nga:

I. Departamenti i Inxhinierisë Matematike:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike;
2. Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh;

II. Departamenti i Inxhinierisë Fizike:

1. Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, Profili Inxhinier Fizike
2. Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, Profili Fizikan Mjekësor.

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët të cilët kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe të plotësojnë kriteret e pranimit të cilat i gjeni në Rregulloret përkatëse të programeve të studimit të ciklit të dytë, Neni 5 “*Kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve*”, në faqen web të fakulteti.

Aplikimet kryhen pranë sekretarisë mësimore , deri më **04.10.2023**.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANË
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Dokumentacioni për aplikim

Bazuar tek Udhëzimi Nr. 17, datë 30.07.2019

.....
9. Kandidati paraqet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) *Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar, mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.*
- b) *Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar", paraqesin Dëftesën e pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar studimet dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.*
- c) *Formularin e aplikimit, sipas formatit përkatës.*
- d) *Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
- e) *Dy fotografi personale.*